

PARTIA “BALLI KOMBETAR”

TIRANE

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE REGJISTRUAR

**Per Auditimin Ligjor të Fondeve të përfituara
Për Fushatën Zgjedhore 2015**

Tirane 28 Tetor 2015

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR

Drejtuar: Komisiont Qëndror të Zgjedhjeve

(Bulevardi: “ Dëshmmorët e Kombit” Pallati I Kongreseve)

Tiranë

Partia Balli Kombetar

(Rr. “Kavajes” ish Shtepia Botuese Naim Frasheri)

Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Ne cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar, bazuar në ligjin 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në zbatim të Vendimit të KQZ, datë 10.08.2015, si dhe Kontratën e Shërbimt nr.7709, datë 29.09.2015, kemi audituar pasqyrat financiare që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, që fillon me datë 21.05.2015, me regjistrimin e Partisë Balli Kombetar në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 21.06.2015, me përfundimin e fushatës zgjedhore, të 21 qershorit të vitit 2015.

Pergatitja e ketyre pasqyrave eshte pergjegjesi e Partise Balli Kombetar e cila eshte pergjegjese per pergatitjen dhe paraqitjen ne menyre te sinqertë të këtyre pasqyrave në përputhje me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe ligjin nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” datë 29.09.2004. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave.

Përgjegjësia jonë është që bazuar në auditimin e kryer, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, referencë të veçantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojme dhe të kryejme auditimin per te zoteruar siguri te arsyeshme se keto pasqyra nuk permbajne anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare, që përfshijnë : Librin e llogaritjeve të subjektit, Regjistrin e posaçëm, të miratuar si model me vendim nr.266 të KQZ-së, datë 01.06.2009 si dhe Pasqyrën e arkëtim pagesave.

Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës. Në çmujmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara, për fushatën zgjedhore të Partisë Balli Kombetar, që fillon me datë 21.05.2015 dhe mbyllet me datën 21.06.2015, janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e

arkëtimeve dhe pagesave, konform ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”, duke dhënë **një pamje të vërtetë dhe të sinqertë.**

Lefteri Kushta
Ekspert Kontabël I Regjistruar
Lic. 58 date 31.01.2000

Tiranë më 28.10. 2015

I . INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

I.1 Baza ligjore kryerjen e ketij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë”.
- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin Nr.10374, date 10.02.2011.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,,
- Cdo dokument ligjor të marrë prane Partisë “Balli Kombetar”.

I.2 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partisa “Balli Kombetar” e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar,ne baze te Vendimit te Ministrise se Drejtesise Nr.39/1 date 04/10/1991. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2000 “Per Partitë Politike”, të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimpruese “, të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 “Për Regjistrimi e Organizatave Jofitimpruese”, nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi.

Subjekti zgjedhor “Balli Kombetar” është një organizatë shqiptare e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Qellimi: Lufton per te krijuar kushtet e bashkimit shpirtëror dhe politik te popullit shqiperar, per lartësimin ekonomik dhe kulturor te tij dhe per barazine e te drejtave te njeriut. Ajo kerkon te forcoje ndergjegjen kombetare te shqiptareve dhe te hedhe bazat e nje morali politik kombetar. Ajo ndihmon per ndriçimin e opinionit shoqëror mbarekombetar rreth problemeve te ndryshme politike, ekonomike dhe kulturore. Kerkon te ngreje lart shkallen e zhvillimit ekonomik, kulturor dhe shkencor te popullit shqiptetar, perpiqet per rritjen e rolit politik, shoqëror dhe kulturor te anetareve te saj ne jeten e vendit tone. Ndhmon per forcimin dhe persosmerine e bazes ligjore te shtetit shqiptetar, forcimin e institucioneve, per begatine e vendit dhe permiresimin e kushteve lendore kulturore te popullit tone.

Mbron idealin e nje te drejtesie shoqërore. Lufton per nje shtet shqiptetar te lire brenda kufinjve natyrore te tij.

Qendra e partise është në Rr. “Kavajes” ish Shtepia Botuese Naim Frasheri .

Organet drejtuese ne udheheqijen qendrore janë:

- Kongresi
- Keshilli kombetar
- Kryesia
- Komisioni Qendror i Kontrollit

Kryetar i partise është zgjedhur z.Adriatik Alimadhi i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të “ Balli Kombetar ,,.

Te ardhurat Financiare te Partise perbehen nga :

- Kuotat e patrise
- Buxheti i shtetit, sipas ligjit per financimin e partive politike.
- Te ardhurat nga shfrytezimi i pasurive te tundeshme dhe te pa tundeshme te partise
- Te ardhurat nga ndermarjet e partise
- Te ardhurat nga veprimtaria botuese e partise
- Nga ndihmat e dhuratat nga anetaret dhe simpatizantet e partise
- Mjetet e dhuruara me testament partise
- Te ardhurat nga veprimtarite me pagese
- Te ardhura te tjera ne perputhje me ligjet e shtetit. Kontribute vullnetare te qytetareve, institucioneve, ndermarjeve, organizatave, etj.

II. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL

II.1 Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

- a) Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,, dhe Planin Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhen vendase në Leke.
- b) Rregullat për vleresimin e kërkesave për arkëtim dhe të detyrimeve.
Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara nga klientet apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabël.
- c) Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve.
Gjendjet e likuiditeteve përfshijne gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.
- d) Të Ardhurat
Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga dontorët dhe perdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar nga projekti.

2 ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”. Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontrolli i brendshem kryhet nga dega e finances. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale.

A. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

1.Partia “Balli Kombetar” ka realizuar të ardhur për fushatën zgjedhore nga buxheti i shtetit ne masen 875.920 leke fonde te cilat kane kaluar ne llogarine likuiduese te Partise prane BKT ne date 24/06/2015.

2. “Balli Kombetar” nuk ka realizuar Shpenzime për fushatën zgjedhore .

B. Pasqyra e arkëtimeve dhe pagesave

Nga verifikimi i likuiditeteve në arkë dhe bankë rezulton se Partia “Balli Kombetar” ka arketuar fonde për fushatë zgjedhore nga buxheti i shtetit në shumen 875.920 leke. Ndersa nga donatore të tjere nuk ka perfituar asnje fond.

	<i>Në fillim të fushatës Lek</i>	<i>Në fund të fushatës Lek</i>
Depozita në bankë (lek)	5.085	880.755
Para në Arkë	0	0
Totali	5.085	880.755

Gjate kesaj periudhe jane likuiduar vetem komisionet bankare mujore ne shumen 250 leke.

C. Lidhur me zbatimin e kerkesave te Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë

1. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet publike

OBJEKTIVI : LIGJI Nr.10 019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar, Neni 87 “Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondeve publike për subjektet zgjedhore” pika 2 e cila shpreh se“ Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme”

KONSTATIMI : Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka qene perfitues i fondeve publike per Zgjedhjet Vendore 2015 ne masen 875.9203 leke te cilat nuk jane perdorur.

2. Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike

OBJEKTIVI : LIGJI Nr.10 019, datë 29.12.2008 KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË i ndryshuar,

-Neni 89 pika 1, I cili shpreh se “Financimi i subjekteve zgjedhore nga fondet jopublike”, I cili shpreh:” Subjektet zgjedhore mund të marrin, për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore, fonde vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas. Për qëllim të këtij Kodi, konsiderohet person fizik vendas edhe shtetasi shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

-Neni 89 pika 2, i cili shpreh se shuma qe cdo person fizik ose juridik mund ti jape nje subjekti zgjedhor nuk mund te jete me e madhe se 1 milion leke ose kundervlefta ne sende ose sherbime.

-Neni 89 pika 3 i cili shpreh se Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme: a) ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë; b) ushtron veprimtari në fushën e medias; c) ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; ç) ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shtetit ose ndaj çdo institucioni public”

KONSTATIMI : Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka perfituar nuk ka perfituar fonde sipas ketyre neneve.

3. Respektimi i kerkesave te Nenit 90 te Ligjit

- **Neni 90 pika 1** shpreh : Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, miratuar si model me vendim të KQZ-së, shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin qartë të dhuruesit. Në çastin e dhurimit, dhuruesi nënshkruan një deklaratë, ku zotohet se ai nuk ndodhet në një nga rrethanat e përcaktuara në nenin 89 të këtij Kodi dhe mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës miratohet nga KQZ-ja dhe është e detyrueshme për t'u nënshkruar në çdo rast dhurimi. Lista e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse duhet të bëhen kurdoherë publike.

- **Neni 90 pika 2** shpreh : Dhurimi fondeve me vlere me te madhe se 100.000 leke duhet te behet vetem ne nje llogari te posacme te hapur ne nje banke nga subjekti zgjedhor.Pergjegjsi i finances se subjektit zgjedhor, jo me vone se tre dite nga fillimi I fushates zgjedhore, deklarom numrin e llogarise bankare te hapur per kete qellim.Numri i llogarise bankare per cdo subjekt politik publikohet ne faqen zyrtare te KQZ-se.

- **Neni 90 pika 3** shpreh : Shpenzimi total qe mund te kryeje nje parti politike, perfshire dhe kandidatet e tyre, per nje fushate zgjedhore nuk duhet te kaloje 10-fishin e shumes me te madhe qe nje subject zgjedhor ka marre nga fondet publike sipas nenit 87 te ketij Kodi.Cdo shpenzim I kryer per fushaten zgjedhore dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor ne fuqi.

KONSTATIMI : Nga verifikimet e kryera rezultom se:

- subjekti zgjedhor ka nje regjister te posacem sipas modelit te miratuar nga KQZ-ja.
- Nga verifikimet e kryera rezultom se subjekti nuk eshte zoterues i nje llogarie te vecante per fonde per qellim te fushates zgjedhore por ka perdorur llogarine e tij likujduese te hapur prane BKT me numur 110000873CLTJCLALL.
- Shpenzimet ne total te kryera nuk kalojne 10 fishin e fondeve publike te perfituara, ne respekt te nenit 90 , pika 3(nuk ka shpenzime te kryera)

Eksperte Kontabel e Regjistruar
Lefteri KUSHTA

Tirane me 28 Tetor 2015